

LIGJ
Nr.8183, datë 20.1.1997

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7978, DATË 26.7.1995 "PËR FORCAT E ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 16 e 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e deputetit Afrim Krasniqi

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në nenin 24 shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

"Shtetasit që kanë përfunduar dhe që do të përfundojnë studimet e larta me shkëputje nga puna brenda dhe jashtë vendit, kur kanë bërë në shkollën e mesme programet e plota të edukimit ushtarak, përjashtohen nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij qysh nga data 26.7.1995.

Shpallur me dekretin nr.1709, datë 27.1.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha